

04.04.2023  
Ora 12:08

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: "Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 43, datë 01.04.2023, me ankues z. Eduard Nallbani", ka si objekt "Kundërshtim i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** PD (L. Nuraj, F. Nuri)

**Z. E. Çefa:** Mirdita të gjithëve! Deklarojmë të hapur seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 43, datë 01.04.2023, sipas ankimit të paraqitur nga z. Eduard Nallbani", i cili kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 220 datë 30.03.2023. Verifikojmë fillimisht listprezencën, është prezent trupa e plotë e KAS-it, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata të cilët përfaqësojnë Komisionerin në këtë shqyrtim administrativ. Është njoftuar rregullisht dhe ka marrë dijeni edhe ankuesi por nuk është paraqitur megjithëse ne e pritëm përtej orarit të caktuar për fillimin e seancës. Në këto kushte besoj që nuk kemi pengesë për të filluar rregullisht me dëgjimin e Sekretarit të Përgjithshëm për parashtrimin shkurtimisht të rrethanave të ankimit. Zoti Merkaj, fjala për ju!

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. Y. Merkaç:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 145 të vitit 2023 ka regjistruar Komitetin Nismëtar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për anëtar të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë. Edhe ne vendimin numër 220 datë 30.03.2023 Komisioneri ka marrë në shqyrtim kërkesën për regjistrim të zotit Eduard Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur mosregjistrimin e zotit Eduard Mehmet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zgjedhjet e zonës zgjedhore Bashkia Tiranë për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 me arsyetimin se ka mandat në Kuvend dhe në Këshillin Bashkiak i është kërkuar lista mbështetëse (që mbashtesin kandidatin). Në këtë dokumentacion të paraqitur kandidati për Këshillin Bashkiak ka sjellë 109 nënshkrime në një kohë që në ekstraktin e fundit të listës zgjedhore të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë janë regjistruar 699,748 zgjedhës ose thënë ndryshe 1% e zgjedhësve është 7,000. Sipas nenit 68 pika 2 të Kodit Zgjedhor duhet të kishte paraqitur të paktën 3,000 firma. Me këtë arsyetim Komisioneri e ka rrëzuar kërkesën dhe nuk e ka regjistruar si kandidat për atëtarë të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim zoti Eduard Nallbani i cili pretendon se nuk përfshihet në pikën 3 të nenit 70 ku pretendon se lista e mbështetësve përkohë vetëm për Kryetar Bashkie dhe jo për anëtar të Këshillit Bashkiak. Në këto kushte kërkon shfuqizimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe regjistrimin e tij si kandidat i pavarur për anëtar të Këshillit Bashkiak, Tiranë. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit zoti Merkaç! Pyetje nga kolegët? Kam unë një pyetje, në mos të gaboj ju thatë që e ka sjellë një listë me 109 mbështetës apo jo? Që

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

nënkupron së ai vetë e ka filluar procedurën e mbledhjes së firmave por sigurisht është shumë larg limitit që ligji parashikon.

**Z. Y. Merkaj:** Po!

**Z. E. Çefa:** Dakord, faleminderit! Besoj në këtë pikë do të kalojmë në konkluzione direkt. Zoti Sekretar i Përgjithshëm shkurtimisht çfarë kërkoni?

**Z. Y. Merkaj:** Shkurtimisht kërkojmë qëndrimin në fuqi të vendimit Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 220 datë 30.03.202. Rrëzimin e kërkesës ankimore të kërkuesit Eduard Nallbani. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Faleminderit! Atëherë KAS do të tërhiqet për vendim dhe do të shpallim për pak minuta.

Riçelim seancën për shpalljen e vendimit lidhur me shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 43. Atëhere KAS mbledhur në formë këshillimi vendosi rrëzimin e ankimit të zotit Eduard Mehmet Nallbani. Lënien në fuqi të vendimit numër 220 datë 30.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Apelit Administrativ brënda 5 ditëve.

Seanca deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr. 44**

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

04.04.2023  
Ora 12.32

**RENDI I DITËS**


**Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 38, datë 29.03.2023, me ankues qendra  
“Qëndresa Qytetare”, ka si objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 199, datë  
24.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”**

**PJESËMARRJA:**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** KRIIK, Qëndresa Qytetare, Përfaqësues të Ministrisë së  
Shëndetësisë

**Z. L. Braho:** Mirëdita! Çelim seancën e shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore nr. 38, me ankues Qëndresën Qytetare, me objekt ankimi “Kundërshtim i vendimit nr. 199, datë 24.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Kjo kërkesë është paraqitur në KQZ në datën 29 mars 2023. Në seancën e verifikimit të kushteve të formës dhe të përmbajtjes është vendosur që i përmbush kriteret e parashikuara nga neni 130 i Kodit Zgjedhor dhe për këtë arsye KAS-i e ka kaluar për shqyrtim në seancën e sotme. Atëherë të pranishëm për ankuesin Qëndresa Qytetare është:

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. Dh. Zguro:** Dhimitër Zguro me autorizim.

**Z. L. Braho:** Po, faleminderit! Për Ministrinë ka përfaqësues?

**Z. O. Akshia:** I pranishëm Olsi Akshia, me autorizim, i nderuar, me numër protokolli 136/3 datë 04.04.2023. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Dakord. Faleminderit! Për administratën e KQZ-së është i pranishëm sekretari i Përgjithshëm, zoti Ylli Merkaj. Ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët në lidhje?


**Z. Dh. Zguro:** Jo, i nderuar.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Atëherë ia japim fjalën ankuesit, si fillim të na relatojë shkurtimisht pretendimet e tij në lidhje me kundërshtimin e vendimit nr. 199, datë 24 mars 2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Z. Dh. Zguro:** Faleminderit, i nderuar! Në datën 7 shkurt 2023 ministrja e Shëndetësisë, zonja Ogerta Manastirliu bashkë me drejtuesin politik të qarkut, të Partisë Socialiste, zotin Ulsi Manja, dhe drejtues të tjerë të bashkisë, zotin Pjerin Ndreu dhe drejtues të tjerë të Partisë Socialiste në Qarkun e Lezhës kanë vizituar ambientet e spitalit të Lezhës. Kjo vizitë ka qenë një vizitë publike në këtë spital, e cila është reklamuar ne faqen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe në të gjitha faqet e drejtuesve të tjerë të Partisë Socialiste të Qarkut të Lezhës. Në këtë vizitë ministrja e Shëndetësisë ka reklamuar edhe ka promovuar investimet e kryera ne spitalin e

2

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

Lezhës, duke përfshirë këtu shtimin e disa pajisjeve të reja në këtë spital dhe në të njëjtën kohë ka promovuar dhe ka mbështetur investimet e reja që lidhen me ndryshimin dhe me përmirësimin e infrastrukturës në spitalin e Lezhës jo vetëm në Spitalin Rajonal të Lezhës, por edhe në spitalet e tjera. Në të njëjtën kohë gjatë kësaj vizite të njëjtën fjalë ka mbajtur edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste në Qarkun e Lezhës, zotit Ulsi Manja, duke mbështetur në mënyrë indirekte kandidatin e Partisë Socialiste në Bashkinë e Lezhës, zotin Pjerin Ndreu dhe duke bërë thirrje, në mënyrë indirekte, qoftë përmes postimeve të tyre dhe përmbajtjes së këtyre postimeve, duke përdorur sloganet e Partisë Socialiste, si: “Shqipëria e ardhmja jonë”, “S’ka kohë për pushim” e “Të bashkuar dhe jo të ndarë”. Kanë promovuar dhe kanë mbështetur kështu në mënyrë indirekte, nëpërmjet përdorimit të burimeve publike, siç janë ambientet e spitalit të Lezhës, i cili ka qenë gjatë orarit të punës, ka pasur pacientë gjatë kohës së kryerjes së vizitës së zonjës Manastirliu. Me këta pacientë ministrja ka bërë edhe praktikisht biseda në lidhje me promovimin e investimeve dhe për këtë pjesë kemi kundërshtuar vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili nuk ka gjetur, nuk ka konstatuar shkelje nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me përdorimin e burimeve publike. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Kisha një pyetje para se të kalojmë te pala tjetër: ky aktivitet është publikuar vetëm në rrjetet sociale, apo, në qoftë se keni dijeni, edhe në ndonjë media?

**Z. Dh. Zguro:** Në mediet lokale nuk kemi dijeni nëse është publikuar, por është publikuar të paktën në të gjitha rrjetet sociale edhe në faqet zyrtare të Ministrisë së

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

Shëndetësisë, ku është publikuar dhe është vendosur edhe theksi te prezenca e zotit Ulsi Manja, si drejtues politik.

**Z. L. Braho:** Në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë.


**Z. Dh. Zguro:** Në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë *shëndetsia.gov.al*, i është bashkëlidhur provave. Është prova nr. 7 në *print-skreen* nga faqja e ministrisë, ku theksohet se prioritet është fuqizimi i shërbimit spitalor në të gjithë Qarkun e Lezhës. Kemi përfunduar spitalin e Laçit, kemi filluar punë për rehabilitimin e spitalit bashkiak të Mirditës dhe vihet theksi bashkë me drejtuesin politik të Qarkut të Lezhës, ministrin e Drejtësisë, Ulsi Manja dhe kryetarin e bashkisë. Ministrja ka parë nga afër investimet në spitalin e Bashkisë së Lezhës, etj. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit! Atëherë fjala për përfaqësuesin e Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në lidhje me prapësimet që keni ju në lidhje me këtë ankim.

**Z. O. Akshia:** I nderuar kryetar, dhe të nderuar anëtarë, vlerësojmë që vendimi i Komisionerit nr. 199, ora 12:00, datë 24 mars është një vendim konform parashikimeve ligjore për legjislacion zgjedhor në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht 2 problematika që janë ngritur dhe që janë sqaruar, edhe për ekonomi do të jem shumë konciz, është pjesa e mosraportimit, që është e ezauruar, që vetë Qëndresa Qytetare nuk ka arritur të bëjë një hulumtim të saktë në faqen e internetit dhe të verifikonte, domethënë që raportimi është bërë nga ministria. Ishte shumë e thjeshtë situata, sepse nga raportimet mjaftonte të bëje *search* me Spitali Rajonal i

4

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

Lezhës dhe të dilte, duke qenë se aktiviteti zhvillohej atje. Motori i kërkimit që është zhvilluar mund të jetë bërë, për shembull, te Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë arsye nuk i ka dalë palës në kërkim. Mbas verifikimit, edhe në procedurën e mëparshme hetimore administrative të zhvilluar nga KQZ-ja është bashkëlidhur dhe raportimi brenda afateve, brenda afatit 5 ditor nga ana e Ministrisë. Referuar edhe organizimit të eventit, sqarojmë që ishte një event në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht edhe me nenin 3, pika1/1 nënpika “B” të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator: “Veprimtari të ndaluara për t’u promovuar janë veprimtaritë publike për të cilat janë dhënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike jo sipas fondit buxhetor të miratuar në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve”. Nuk ka qenë veprimtari e ndaluar për shkak se fondet ishin më të hershme sesa kjo periudhë. Kështu që edhe ky pretendim nuk qëndron. Kjo është e dokumentuar edhe gjatë procesit hetimor administrativ në KQZ. Referuar edhe pretendimeve të tjera vlerësojmë që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka bërë një hetim të plotë, ka vlerësuar situatën dhe ka arritur në një përfundim të drejtë duke mos pranuar ankesën e Qëndresës Qytetare. Për sa më sipër vlerësojmë se kjo kërkesë duhet rrëzuar dhe ankesa. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Fjala për përfaqësuesin e KQZ-së, sekretarin e Përgjithshëm.

**Z. Y. Merkaç:** Faleminderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 24 mars 2023 ka marrë në shqyrtim administrativ 39 denoncime nga 24 institucione publike, për të cilat pretendohet se bien në kundërshtim me parashikimet e neneve

5

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Ndër të tjera, në përfundim të shqyrtimit administrativ ka vendosur për ministren Ogerta Manastirliu pushimin e procedimit, pasi nuk është në kundërshtim me nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Komisioneri ka arsyetuar se gjatë verifikimit të fakteve, të rrethanave dhe të provave të lidhura me sa më sipër, të verifikimit edhe të materialit filmik të marra nga denoncimi, por dhe nga pretendimet e palës në seancë, rezultoi se në ndërfaqen e raportimeve Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale është raportuar kryerja e këtij aktiviteti, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Gjithashtu, për sa u përket veprimtarive publike në kuptim të nenit 3, pika 1.1 të vendimit nr. 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, “Veprimtaritë e ndaluara për të promovuar janë veprimtaritë publike për të cilat janë vënë rishtazi ose/apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve”. Në këto kushte veprimtaria e zhvilluar nga pala e denoncuar në këtë proces nuk përbën veprimtari të ndaluar për t’u promovuar. Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, si dhe nga mbikëqyrja e materialeve filmike nuk rezulton që në këtë aktivitet të jetë mbajtur deklarimi apo thirrje elektorale nga asnjë prej pjesëmarrësve, por deklaramet janë bërë me zhvillimin e politikave e të strategjive shtetërore në fushën e shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor. Në përfundim të procesit administrativ Komisioneri ka vlerësuar se kjo veprimtari nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe në këto kushte ka vendosur pushimin e shqyrtimit administrativ për ministren Ogerta Manastirliu. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*


**Z. L. Braho:** Faleminderit! Paraprakisht unë do të doja nga administrata edhe këtë *screenshot*-in që është me raportimin, se nuk e kemi këtë të raportimit. Kolegët kanë ndonjë pyetje për palët?

**Z. K. Bele:** Kisha një pyetje për “Qëndresën”, për ankuesin. Desha vetëm të kuptoj, pra, ju thoni që është veprimtari e ndaluar (është debat që e kemi pasur edhe në çështje të tjera), mbasi ka përdorur burime shtetërore. Në kuptimin tim një aktivitet që ka të bëjë me promovimin e një spitali, apo të një shkolle, në një rast të një ministrie tjetër apo të një objekti, po themi, bujqësor, do të kryhet në hapësirat e atij ambienti. Pra, nuk do të kishte sens që një veprimtari ku promovohet spitali të kryhej në një ambient tjetër privat, përveçse në spital. Kështu që besoj se në vetvete thelbi nuk ka të bëjë me vajtjen e ministrit në spital, siç e kuptoj unë nga ankimi, por me faktin që ministrja e Shëndetësisë, në këtë rast, ka pasur ministra të tjerë, siç është ministri i Drejtësisë, apo në një rast hipotetik, kryetari i bashkisë apo funksionarë të tjerë politikë. Sipas jush, që veprimtaria të ishte korrekte, do të duhet të ishte vetëm ministri i Shëndetësisë dhe të mos shkonin ministra të tjerë, apo të shkonin dhe të mos flisnin? Pra, ka ndalim që kur një ministër apo një titullar kryen një aktivitet, në atë aktivitet të mos ketë pjesëmarrës të tjerë, në këtë rast ministra të fushave të tjera? Këtë desha të kuptoj.

**Z. Dh. Zguro:** Faleminderit, për pyetjen! Në kuptimin tim, sigurisht, promovimi i një investimi ose i një projekti publik, siç mund të jetë spitali, nuk mund të kryhet në ambiente të ndryshme, por prania e ministrit të Drejtësisë tregon qartësisht natyrën politike të këtij aktiviteti. Jo për faktin se është ministër i Drejtësisë, sigurisht edhe kjo sepse ministri i Shëndetësisë nuk ka asnjë lloj ndikimi në

7

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

hartimin e politikave shëndetësore dhe nuk gjej dot një arsye logjike, edhe brenda kufijve të ligjit, se pse ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë në një aktivitet që ka lidhje me promovimin e një spitali. Në të njëjtën kohë, në kuptimin tonë, përveç pjesës së investimeve, është vënë në përdorim edhe një burim publik, siç është Spitali Rajonal i Lezhës, në mbështetje dhe për qëllime elektorale, për të reklamuar qoftë investimet që janë kryer, por qoftë edhe investimet që do të kryhen në rast se banorët e Qarkut të Lezhës do të vazhdojnë të mbështesin një subjekt të caktuar politik. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** ...lexohet, aty, të paktën, nuk bëhet fjalë, ose nuk ka thirrje, nga hetimi i Komisionerit, nga sa verifikojmë, nuk ka thirrje që lidhen me zgjedhjet lokale. Unë besoj ose do të doja të diskutonit, të dija mendimin tuaj, sipas ankuesit, në këta katër muaj ministrat nuk duhet t'i kryejnë këto aktivitete promovuese, se biem dakord që qeveria do të promovojë aktivitetet që kryen? Çështja është që nuk duhet t'i bëjnë fare këto aktivitete në këta katër muaj, apo një ministër duhet të shkojë vetëm, të mos marrë ministra të tjerë, sepse në parantezë si buxheti i shtetit, si aktet e ndryshme, vendimet e Këshillit të Ministrave, në fakt, nuk miratohen vetëm nga ministri? Dhe siç e kuptoj unë, tipikisht, ministrat si në aktivitetin e përditshëm në parlament apo në situata të ndryshme kanë njëlloj konvergimi dhe njëlloj bashkëpunimi politik. Kjo ndodh gjatë gjithë periudhës së funksionimit të një qeverie.

**Z. Dh. Zguro:** Në referim të pikave 1 dhe 2 të nenit 91, por edhe në referim të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9, të nenit 3, në këndvështrimin tonë,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

përbën një veprimtari të ndaluar promovimi i çdo veprimtarie publike apo i investimeve të kryera gjatë periudhës katër mujore.

**Z. K. Bele:** Vendimin nr. 9 e lidh me transferimin e fondeve publike. Pra, ka një koncept tjetër: të ndalon që në atë periudhë të alokosh fonde. Pra, nëse do të dilte ministri dhe të thoshte: “sot u miratua një fond i ri”, diskutimisht mund të vinte në kategorinë e këtyre ndalimeve, është bisedë tjetër, por në rastin e një promovimi të një investimi, i cili afërmendsh mund të ketë filluar muaj apo vite më parë, nuk e shoh se ku bie në kategorinë e vendimit nr. 9.


**Z. Dh. Zguro:** Nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk është kryer një hetim i plotë në lidhje me vënien në dispozicion të këtyre aseteve, më saktë, të fondeve në këtë periudhë, sepse është pranuar dhe është marrë e mirëqenë deklarata e Ministrisë së Shëndetësisë, që fondet nuk janë vënë në dispozicion rishtas.

**Z. I. Rusmali:** Edhe për përfaqësuesin e ankuesit e kam. Ju e keni nisur denoncimin tuaj për veprimtaritë pa raportuar, siç e kuptoj unë, apo e kam gabim?

**Z. Dh. Zguro:** Denoncimi ynë është kryer për dy pika. Së pari, për veprimtarinë e raportuar, sepse nga ana e vëzhguesve të Qëndresës Qytetare është kërkuar me *key words* dhe është kërkuar pranë institucionit të Ministrisë së Shëndetësisë, në ndërfaqen e raportimeve dhe për rrjedhojë nuk na ka rezultuar, ndërkohë që më pas, kur jemi njoftuar në seancë dhe kur kemi bërë kërkimin me *key words*-in: “Spitali Rajonal i Lezhës” ka rezultuar që veprimtaria është raportuar në ndërfaqen

9

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

e raportimeve, por nëse klikon në ndërfaqe, duke përzgjedhur si institucion Ministrinë e Shëndetësisë, nuk ka rezultuar i raportuar. Pika e dytë, për të cilën ne kemi bërë ankimin pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka qenë për përdorimin e burimeve publike. Pra, ka qenë për dy shkelje. Nga ana jonë, në denoncimin tonë, janë pretenduar dy shkelje, ndërkohë që ankimi është bërë vetëm për pjesën e përdorimit të burimeve publike. Faleminderit!


**Z. Dh. Zguro:** Ndërkohë që për ankimin jemi vetëm, pra ankimi është bërë vetëm për pjesën e përdorimit të burimeve publike. Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Në ankesën tuaj, te pika 11, thoni se Ministria e Shëndetësisë ka pretenduar se ky aktivitet nuk ka qenë i hapur për publikun. Nga vendimi Komisionerit unë nuk e lexoj këtë. A është pretenduar në seancën që ka zhvilluar Komisioneri?

**Z. Dh. Zguro:** Është edhe në vendimin e Komisionerit, edhe në seancë. Ministria e Shëndetësisë ka pretenduar që nuk ka qenë një aktivitet publik, nuk ka qenë një aktivitet i hapur për publikun.

**Z. I. Rusmali:** Por, e ka raportuar, apo nuk ka qenë ministria që e ka raportuar?

**Z. Dh. Zguro:** Po e ka raportuar, por ministria, nga ana tjetër, ka pretenduar që nuk ka qenë një aktivitet i hapur për publikun.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. I. Rusmali:** Besoj se në seancë është diskutuar çështja e alokimit të fondeve. Kanë qenë përpara periudhës 4 mujore, apo jo? Ju vetë keni investiguar me mjetet tuaja për këtë gjë?

**Z. Dh. Zguro:** Për aq mjete sa kemi në dispozicion, është investiguar, por nuk kemi arritur në ndonjë përfundim konkret. Kështu që i takon Ministrisë së Shëndetësisë të provojë të kundërtën.

**Z. I. Rusmali:** Gjithsesi ju i qëndroni faktit që përbën përdorim të burimeve shtetërore përdorimi i ambienteve të spitalit dhe përdorimi i faqes zyrtare të ministrisë. A ka ndonjë gjë tjetër që mund të shtohet te kjo listë, në vlerësimin tuaj?

**Z. Dh. Zguro:** Përdorimi i ambienteve të spitalit, në të njëjtën kohë dhe i gjithë infrastrukturës, edhe i burimeve njerëzore, sepse gjatë kohës, që ministrja ka bërë vizitën, siç del qartë edhe nga pamjet filmike, janë përdorur edhe burimet njerëzore të institucionit, sepse ka pasur mjekë që kanë qenë në orarin e punës duke kryer vizita dhe konsulta, për rrjedhojë edhe burimet njerëzore të institucionit.

**Z. I. Rusmali:** Janë shmangur nga punët e tyre të zakonshme për të ndjekur vizitën e ministres, po thoni?

**Z. Dh. Zguro:** Mjekët e kanë shoqëruar ministren gjatë orarit të punës në të gjithë turin që ajo ka bërë. Në një video, që është 7 minuta dhe 43 sekonda, në mos gaboj, ministrja është gjithmonë e shoqëruar nga mjekë të spitalit rajonal Lezhë.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. I. Rusmali:** Sipas ligjit përdorimi i burimeve njerëzore kërkon detyrimin e tyre për të bërë diçka kundër vullnetit të lirë. Në këtë rast, në shoqërimin e ministres, a jemi përpara një situatë kur mjekët kanë bërë një gjë kundër vullnetit të tyre? A mund të jemi eventalisht, se nuk është e thënë ta themi me siguri gjënë, mund ta themi edhe...

**Z. Dh. Zguro:** Po, eventalisht jemi.

**Z. I. Rusmali:** Mund të jemi. Mund të ketë pasur mjekë...

**Z. Dh. Zguro:** Po të cilët janë detyruar që...

**Z. I. Rusmali:** Të cilët në vend që të preferonin të vizitonin pacientët, janë detyruar të ndërpresin vizitat. Por nuk e provojmë dot këtë?

**Z. Dh. Zguro:** Nuk mund të them me siguri, nëse mjekët janë detyruar, por është e qartë që gjatë të gjithë kohës, ministrja është shoqëruar nga mjekët, dhe ministrja ka qenë e pranishme gjatë kohës që janë kryer kontrole mjekësore ndaj pacientëve, dhe ka marrë pjesë në vizita që janë bërë ndaj pacientëve nga ana e mjekëve të spitalit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Z. L. Braho:** Kam unë një pyetje për përfaqësuesin e ministrisë. Kemi statuset në Facebook që janë edituar disa herë që i ka sjellë si provë pala paditëse, dhe editimi,

12

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

me sa shoh unë, ka të bëjë me pjesën e personave të pranishëm, pra një herë përfshihen me emra personat e pranishëm, një herë tjetër nuk përfshihen fare. Tani te statuset në *Facebook* janë thjesht me emra pa cituat cilësinë e tyre. Te raportimi që është bërë në faqen e KQZ-së pjesëmarrësit janë kryetarë bashkie, deputetë, përfaqësues të OSHKSH-së dhe personel mjekësor. Te njoftimi që është bërë në faqen e ministrisë thuhet: Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu, bashkë me drejtuesin politik të qarkut të Lezhës, ministrin e Drejtësisë Ulsi Manja dhe kryetarin e bashkisë e të tjera. A mund të na e sqaroni ju, nëse e keni si informacion, cili ka qenë roli i zotit Ulsi Manja? Pra, ka qenë si deputet, si ministër Drejtësie, apo ka qenë si deputet dhe drejtues qarku njëkohësisht në këtë takim? Sepse kjo bëhet e paqartë nga vetë pala që ti përfaqëson, sepse i ka dhënë statuset të ndryshme në raportime të ndryshme.

**Z. O. Akshia:** Faleminderit, për pyetjen. Referuar pyetjes, referuar shpalljeve ose informacioneve në faqen e *Facebook*-ut, dua të sqaroj se në faqen e ministrisë pra, në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është bërë: Manastirliu gati investimi madhor për transformimin e spitalit rajonal të Lezhës; kurse komunikimet e tjera janë bërë në faqen personale të ministres, po ta shikojmë edhe komunikimet.

**Z. L. Braho:** Nuk e kisha për aktivitetin, e kisha për rolin e zotit Ulsi Manja në këtë aktivitet.

**Z. O. Akshia:** Vlerësoj se mund të jemi edhe para një situatë, duke qenë se zoti Ulsi Manja është deputet, është edhe ministër i Drejtësisë, është vendosur vetëm






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

statusi deputet, të cilin e ka përfshirë, dhe personat, që janë marrë me raportimet, kanë menduar që në momentin që është raportuar deputet përfshihet edhe ministër i Drejtësisë, duke qenë se e ka statusin deputet, herën tjetër nëse konstatohet si një gabim material, nëse mund ta quajmë mund të korrigjohet në raportimet e mëvonshme të Ministrisë së Shëndetësisë.

**Z. L. Braho:** Një pyetje tjetër që kam po për ju, ka të bëjë me pjesën, që, siç u tha edhe më parë, aktiviteti në raportim është konsideruar si jo i hapur për publikun, ndërkohë që nga zbardhja e videos, përveçse rezulton të ketë pasur edhe pacientë, por ka pasur edhe një lloj komunikimi. Një nga personat, për shembull, që ka komunikuar me pacientët është zoti Ulsi Manja, cili konkretisht ka thënë: Salla është e pajisur me të gjitha aparaturat e nevojshme me ndërhyrje të nivelit të kompleksitetit të lartë në gjinekologji. Dhe bonusin e bebes: Ta kesh me jetë! Ia dhuron një pacienteje që sapo ka lindur fëmijë. Të njëjtën gjë ka bërë edhe ministrja që i ka dhënë një tjetër nëne bonusin dhe ia vendos pranë fëmijës. Tani në mendimin tuaj këta konsiderohen publik, se staf nuk janë? Dakord për mjekët, ju keni arsytim tjetër, por për këta personat që janë të përfshirë në video dhe nuk janë staf, a konsiderohen publik këta?

**Z. O. Akshia:** I nderuar, unë vlerësoj se personat duke qenë pacientë, të cilët kanë qenë duke kryer vizitat e tyre rutinë sipas sistemit të referimit në spital, dhe këto persona, duke qenë të pranishëm aty, duke qenë dhe një organizim për punën shtetërore, fushë e përgjegjësisë së Ministrisë së Shëndetësisë, konkretisht për promovimin e pajisjeve *deksa* mund të jenë bërë edhe komunikime referuar, mbi të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

gjitha, punëve ose akteve të miratuara nga qeveria dhe që aknë të bëjnë me fushën e shëndetësisë ose mbrojtjes sociale, siç është dhe bonusi i bebes.

**Z. L. Braho:** A ka ndonjë pyetje? Po.


**Z. I. Rusmali:** Ndoshta mund të bëjmë një analizë bashke më përfaqësuesin e Qëndresës Qytetare. Ju kërkoni marrjen e masës administrative ndaj ministres, me sa kuptova unë. Pse ndaj ministres?

**Z. Dh. Zguro:** Desha të bëj një sqarim paraprak në lidhje me një pyetje që më drejtuat më parë. Në faqen 19 të vendimit numër 199 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve gjendet pretendimi i Ministrisë së Shëndetësisë që thotë se ky aktivitet nuk ka qenë i hapur për publikun dhe nuk ka qenë me pjesëmarrjen e medias por pasqyrohet në rrjetet sociale të ministres.

**Z. I. Rusmali:** Pse keni kërkuar gjobë për ministren?

**Z. Dh. Zguro:** Kemi kërkuar gjobë për ministren si titullare e institucionit të Ministrisë së Shëndetësisë që ka organizuar këtë vizitë dhe ka përdorur burimet publike të spitalit të Lezhës duke përdorur infrastrukturën dhe burimet njerëzore.

**Z. I. Rusmali:** Referenca ligjore që ju jepni është neni që bën fjalë për persona që kanë detyra të përcaktuara me ligj. E përkthyer në kontekstin konkret, cila do të ishte detyra e ministres?



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. Dh. Zguro:** Në referim të nenit 3 të vendimit të Komisionit Rregullator, ministrat dhe zëvendësministrat dhe një sërë të tjerë funksionarësh publikë e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë, apo të kontribuojnë në çfarëdo lloj forme në veprimtari publike të ndaluara sipas vendimit. Në këtë rast ministrja ka marrë pjesë, ka drejtuar dhe ka organizuar një veprimtari.

**Z. I. Rusmali:** Kjo është dispozitë ndaluese. Më gjej dispozitën që përcakton detyrën e ministres për të mos vënë në dispozicion të një veprimtarie politike mjediset e spitalit të Lezhës.


**Z. Dh. Zguro:** Duke u nisur nga interpretimi i kundërt i kësaj dispozite, mund të arrijmë në detyrat e ministres së Shëndetësisë.

**Z. I. Rusmali:** Patjetër, atje ku ke një ndalim, ke një detyrim për të mos e bërë. Ka një dispozitë tjetër ai vendim që përcakton se titullarët i institucioneve të mos vënë në dispozicion asetet, në këtë rast kujt do t'i përkiste ky detyrim?

**Z. Dh. Zguro:** Drejtorit të spitalit të Lezhës.

**Z. E. Çefa:** Unë doja ta sqaroja pak këtë që u shtjellua nga pyetjet e kolegut. Ju thatë se është raportuar si aktivitet, jo nga ministria, por nga...

**Z. Dh. Zguro:** Është raportuar nga ministria.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. E. Çefa:** Është raportuar nga ministria, si organizator i akti vetit, është vetëdeklaruar Ministria e Shëndetësisë?

**Z. Dh. Zguro:** Po.

Z. E. Çefa: Pyetja tjetër ka të bëjë me faktin që ju në ankim dhe në denoncim keni trajtuar me hollësi ndryshimet që janë bërë herë pas here postimeve në faqen e *Facebook* -ut. Tani, të lutem, a mund të më thoni arsyen pse e keni theksuar këtë fakt dhe çfarë keni dashur me na nënvizuar ose sqaruar?


**Z. Dh. Zguro:** Të paktën në këndvështrimin tonë ndryshimi postimeve tregon edhe vetë faktin që Ministria e Shëndetësisë është koshiente për shkeljet ligjore që ka kryer dhe ka dashur të përmirësojë, të paktën në sy të publikut dhe të përmirësojë edhe në faqen e saj të *Facebook*-ut postimin në rrjetin social me qëllim për t'iu dukur sikur nuk ka shkelje, me qëllim për të mbuluar shkeljet, për t'i fshehur ato.

**Z. E. Çefa:** Dakord. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Meqenëse po analizojmë këto shkelje dhe organizata juaj ka eksperiencë, edhe në zgjedhjet e kaluara ju keni bërë bëj sërë ankesash dhe tashmë duhet të jeni një organizatë me eksperiencë, sepse ka vendimmarrje të Komisionerit, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, dhe shoh që te fillimi i procedimit administrativ ju keni kallëzuar rreth 24 persona dhe në përfundim të këtij hetimi keni ardhur me një ankim vetëm për Ministrinë e Shëndetësisë. Çfarë e

17

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*


bën specifike këtë? Pra, deri sa ju nuk jeni ankuar për të tjerët do të thoni se keni rënë dakord me arsyetimin e Komisionerit. Çfarë e bën specifike këtë ankesë? E bën fakti që këtu kanë qenë vetëm ministra, apo ka ndonjë ndryshe nga ankimet e tjera?

**Z. Dh. Zguro:** Faleminderit! Doja të sqaroja se Qëndresa Qytetare në denoncimin e saj ka bërë vetëm një denoncim vetëm ndaj ministres së Shëndetësisë dhe nuk ka bërë denoncime kundrejt subjekteve të tjera, të cilat shprehen në vendimmarrjen numër 199 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për subjektet e tjera Qëndresa Qytetare nuk ka bërë asnjë lloj denoncimi.

**Z. K. Bele:** Kam vetëm një pyetje të shkurtër për këndvështrimin tuaj për këto 5 postimit ose ndryshimin e postimeve si një tentativë për të fshehur. Unë duke i lexuar këto, në fakt, shoh se kanë të njëjtën përmbajtje, kanë ndryshime të vogla dhe janë brenda 4 orëve. Nëse do të supozonim që ka një fshehje në një nga këto postime nuk përmenden ministrat, te rasti i tretë, në postimin e fundit përmendet ministri. Nëse do të kishte fshehje do të ishte vënë herën e parë dhe pastaj do të ishte konstatuar shkelja, mendoj unë me logjikën time, dhe do të ishte hequr. A përjashtoni që këto të jenë thjesht rakordime apo një këshilltar i medias i pasigurtë në punën që bën apo ku di unë dy veta që i ndërhyjnë në punë njëri-tjetrit? Sepse unë shoh që është i njëjti tekst, por me ndryshime milimetrike dhe nuk e kuptoj ku është fshehja. Pra, në vetvete, ndryshimi tekstit, pra për mua patjetër ka diskutime ose më saktë të bën të mendosh që ai që i shkruan këto postime dhe i ndërron në 2-3 orë. mbase mund të jetë joserioze, por fshehje nuk ka, ose nuk e shoh unë. Mund ta kem gabim.

18

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. Dh. Zguro:** Në këndvështrimin tonë kjo lidhet edhe me fshehjen në postimin e fundit, më pas përmendet qoftë zoti Ulsi Manja, Pjerin Ndreu, Eduardi dhe të tjerë, për pjesën e postimit dhe përmbajtjes së postimit, por në këndvështrimin tonë të gjitha ndryshimet e bëra në postim, sepse po të marrim në këndvështrimin e një këshilltari për medien joserioz, do të kemi ndryshime të shpeshta edhe në postime të tjera dhe nga çfarë ne kemi konkluduar të paktën në shumë prej postimeve të Ministrisë së Shëndetësisë nuk është se ka pasur ndonjë ndryshim thelbësor, kështu që jemi marrë edhe më një pjesë investigative, nëse mund të themi, të pjesë së postimit dhe për të konkluduar në lidhje me ndryshimin, gjë që vihet re më pas edhe në reflektimin e postimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë: shëndetësia.gov.al ku përmendet edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste.

**Z. K. Bele:** Ideja është që duke qenë se edhe në postimin e mëvonshëm ata e kanë pranuar që ka qenë ministri, këtu flitet që në postimin e tretë kanë hequr ndonjë fjali të ministrit. Pra, ka qenë ndonjë fshehje për një gjysmë ose, në mos gaboj ose një orë dhe pastaj e kanë rinxjerrë prapë kështu që nuk e kuptoj ku qëndron...

**Z. Dh. Zguro:** Po, sepse nëse një person arrin të shohë postimin gjatë kohës së ndryshimit të tretë, nuk mund të arrijë të kuptojë ndryshimet përfundimtare, sepse kur një postim ndryshon, subjekteve të tjera, të cilat e kanë parë ose janë angazhuar në atë postim, nëse nuk e kërkojnë manualisht, nuk u shfaqet i njëjti postim.

**Z. L. Braho:** Këtë pyetje që po ia drejtojmë përfaqësuesit të ankimuesit, duhet t'ia drejtojmë përfaqësuesit të ministrisë. Besoj se ju jeni njohur paraprakisht me



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

ankimin dhe me këtë argument të ankimuesit, që ka të bëjë me ndryshimin e statusit. Ndoshta keni pyetur këshilltarin për median të ministrisë se cili ka qenë qëllimi i ndryshimit katër herë të këtij statusi duke hequr e duke vënë emra ministrash apo personash të tjerë. Ka pasur ndonjë qëllim? E vërteta është që nuk përputhet me njoftimin që është bërë në faqen zyrtare të ministrisë. Keni informacion për këtë pjesë?

**Z. O. Akshia:** Nuk kam informacion me statuset e raportuara, por di të them që raportimet që janë bërë janë një informacion i përmbledhur, konciz në lidhje me një veprimtari shtetërore që është bërë në faqen personale të *Facebook*-ut të zonjës Manastirliu, që është edhe titullare e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Unë do t'i rikthehem edhe një herë diskutimit që është bërë në fund të videos që është postuar, që ka të bëjë me bonusin e bebes, që si ministri Ulsi Manja, si ministrja Ogerta Manastirliu, gjatë inspektimit, sepse inspektim quhet procedura e ndjekur, kanë dhuruar bonos bebeje, që besoj që është ndonjë çek. Si është procedura? Gjithmonë i japin ministrat këto, apo kanë ndonjë procedurë tjetër që ndiqet në raste më të përgjithshme?

**Z. O. Akshia:** I nderuar, mbi të gjitha ky nuk është objekt i ankimit, por vlerësoj që vetë legjislacioni parashikon mënyrën sesi aplikojnë personat për marrjen e bonusit, që duhet të aplikojnë pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, momentin që kanë certifikatën e lindjes brenda një afati të caktuar dhe kur përmbushin disa kushte. Mund të jetë bërë për persona, vlerësoj, nuk është se kam informacion

20

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

paraprak, që mund të ketë informacion nga drejtoria e spitalit, nuk kam informacion për këtë, dhe thjesht ka qenë honorifike, sepse është procedura ligjore e përcaktuar për dhënien e bonusit për bebet. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Në lidhje me faktin që nuk është pjesë e ankimit, Kodi Zgjedhor e parashikon që në vendimmarrje mund të shkojmë edhe tej ankimit. Faleminderit për pjesën tjetër të shpjegimit, sepse na shpjegove procedurën që ndiqet normalisht për ta përfituar këtë çekun. Ka pyetje të tjera? Keni ndonjë pyetje për palët ndaj njëra-tjetrës? Nuk keni. Atëherë KAS-i do të tërhiqet për vendim, kështu që do të pezullojmë seancën dhe për rreth 20 minuta shpallim vendimin, që i bie diku rreth orës 13.30

**Rifillon seanca**

**Ora 13.36**

**Z. L. Braho:** Atëherë, riçelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr. 38, të paraqitur nga ankuesi Qendra Qëndresa Qytetare. Kas-i, pasi u tërhoq për vendim, me shumicë votash vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 38, paraqitur nga Qendra Qëndresa Qytetare dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 199, datë 24.3.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi. U shpall sot në datën 4 prill 2023. Seanca deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr. 45**

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*

21





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

04.04.2023  
Ora 13.40

**RENDI I DITËS**

**Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 44, paraqitur në KOZ , datë**

**31.03.2023**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:** Aleanca Demokristiane e Shqipërisë

**Z. E. Lako:** Çelim sot seancën e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për verifikimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes për kërkesën ankimore nr. 44 të bërë nga Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, me objekt “Ankesë për kryetarin e KZAZ-së nr. 6 të Bashkisë së Vaut të Dejës, zotin Sokol Shkreli”. Në mbështetje të nenit 129 të Kodit Zgjedhor jam zgjedhur unë relator i kësaj çështjeje. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Përfaqësuesi i ankuesit, ju lutem, identifikohuni.

**Z. Z. Bushati:** Zef Bushati, kryetar i Partisë Aleanca Demokristiane.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, zoti Bushati! Njoftohemi që anëtarët e KZAZ-së janë nisur, por nuk kanë mbërritur, por ne për shkak të orarit që kemi vendosur, jemi të detyruar të vazhdojmë, për më tepër që kjo është një seancë përgatitore, kështu që nuk është se prezenca e tyre në këtë fazë të gjykimit do të jetë shumë e nevojshme

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 1

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

apo do të kërkohet mendimi ose opinioni i tyre. Në qoftë se ata arrijnë deri sa ne të kemi mbaruar seancën, janë të mirëpritur. Pra, siç e theksova, kjo është një seancë për të parë nëse ankesa i ka plotësuar elementet e formës dhe të përmbajtjes konform përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Shkurtimisht, zoti Merkaj, rreth plotësimit të këtyre kërkesave.

**Z. Y. Merkaj:** Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 44, me ankues Partinë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, e cila ankimon vendimin e KZAZ-së nr. 6 Vau i Dejës për mosregjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie të Partisë Aleanca Demokristiane të Shqipërisë. Në arsyetimin e vendimin KZAZ-ja ka arsyetuar se kandidati nuk është regjistruar, pasi i mungon vërtetimi për zotërim mandati, i mungojnë 15 karta ID dhe lista nuk respekton kuotën gjinore, një mashkull, një femër. Për këto arsye, duke mos qenë dakord me vendimin e KZAZ-së nr. 6, Aleanca Demokristiane e Shqipërisë ka ankimuar në KAS vendimin e KZAZ-së. Nga shqyrtimi paraprak i kërkesës, konstatohet që është në përputhje me nenin 130, pasi i plotëson elementet e formës e të përmbajtjes dhe i propozojmë KAS-it të kalojë për shqyrtim në seancë. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Meqë jemi këtu, zoti Merkaj, e keni këtë vendimin e KZAZ-së që kundërshtohet, e dispononi? E kam për administratën.

**Z. Y. Merkaj:** Jo, nuk e kemi dhe për këtë arsye kemi thirrur edhe anëtarin e KZAZ-së.

**Z. E. Lako:** Sepse me çfarë konstatoj unë, kjo është më shumë një ankesë drejtuar Komisionerit, sesa kundër mosmarrjes së vendimit apo që kundërshton vendimin,

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 2

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

sepse në praktikën që na keni sjellë, nuk ka ndonjë vendim të KZAZ-së. Edhe ju nuk e dispononi. Të dëgjojmë ankuesin. Po, zoti Bushati, vetëm për elementet e formës dhe të përmbajtjes është seanca e sotme, pra është identifikuar akti që kundërshtohet që është marrë nga KZAZ-ja, ose, nëse nuk është marrë, çfarë kërkohet nga KAS-i? A është kompetente trupa jonë për ta marrë këtë vendim? A është bërë brenda afatit? Për këto do të diskutojmë sot.

**Z. Z. Bushati:** E para, ne nuk e disponojmë vendimin e KZAZ-së dhe në shkresën tonë e tregojmë që ne nuk e disponojmë vendimin e KZAZ-sw për mosregjistrimin e këshilltarit. Në fakt, nuk është fjala vetëm për një këshilltar, por për një grup prej 32 kandidatësh për këshilltarë. Historikisht, po e them unë ngjarjen me sy fjalë, megjithëse këtu kam përfaqësuesin e autorizuar për të depozituar dokumentacionin në KQZ, dokumentacioni është depozituar në kohën ligjore, ka marrë edhe procesverbalin për dorëzimin e dokumentacionit dhe i është thënë që tek lista e kandidatëve për këshilltarë ka një parregullsi, diku nga mesi e poshtë. Pra, ka pasur një keqkuptim nga e ana e kandidatit tonë, ka menduar se 30% e listës duhet mashkull-femër dhe pastaj ka vazhduar pa e ndjekur këtë rregull. E ka marrë menjëherë një kopje tjetër të pastër nga selia e partisë dhe e ka realizuar këtë vërejtje të KZAZ-së brenda afatit kohor, madje edhe më shpejt akoma. Ka shkuar atje për të dorëzuar dokumentacionin, nuk ka pasur njeri, zyra ka qenë e mbyllur, ka shkuar jo në datën 28, por në datën 29, sepse në datën 28 ka qenë në Tiranë që mori formularët e paplotësuar dhe në datën 29 u paraqit te zyrat, por nuk gjeti njeri. E ka marrë në telefon kryetarin e KZAZ-së dhe i ka thënë unë jam në Tiranë, KQZ për të dorëzuar dokumentacionin, ti je i skualifikuar. Më tej ka pyetur një tjetër anëtar të KZAZ-së, kësaj here jo nga të maxhorancës, por nga të opozitës, ai i thotë që ne nuk dimë gjë fare, se nuk na thotë njeri çfarë bëhet, vetëm dimë që dera është e mbyllur dhe

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

mbledhje nuk kemi bërë. Më merr në tel e më thotë që kryetar kështu e kështu është problemi. I thashë, nuk ka të drejtë ligjore, ai duhet të jetë aty, ne kemi kohë jo 48 orë, por 72 orë në dispozicion që të plotësojmë këtë vërejtje që ka kërkuar kryetari i KZAZ-së. Nuk ka pranuar as të vijë, as të kontaktojë, asnjë gjë, një sjellje pak brutale nga ana e tij, dhe u detyruam që brenda afatit në datën 30 të depozitojmë ankesën tonë pranë Komisionerit, një kopje e bëmë edhe për KAS-in, por na thanë që përderisa është për Kryekomisionerin, e kalon vetë ai te KAS-i. Këto janë të gjitha motivet që ne sot jemi këtu.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, zoti Bushati! Mirë do të ishte të ishin edhe përfaqësuesit në këtë fazë, meqë kemi një mos marrje vesh në këtë fazë ndërmjet jush dhe KZAZ-së, por dua t'ju kujtoj që në mbështetje të akteve që sot janë në fuqi, ankesa juaj duhet të identifikonte Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, pasi, sipas Kodit Zgjedhor, për marrjen apo mosmarrjen e vendimeve të KZAZ-së ju keni të drejtë të ankoheni brenda 3 ditësh në Komisionin e Ankimeve e Sanksioneve. Pra, vini direkt te ky Komision, nuk është se i drejtoheni Komisionerit. Gjithashtu, bashkëlidhur duhet edhe vendimi i KZAZ-së, nëse është marrë, dhe, nëse nuk është marrë, duhet të kërkonit nga KAS-i marrjen e këtij vendimi dhe procedimin pastaj me regjistrimin ose jo të listës në varësi të provave që do të paraqiten në seancë. Ndonjë nga kolegët ka ndonjë mendim ose ndonjë pyetje në lidhje me këtë çështje?

**Z. K. Bele:** Ajo që po thotë relatori, nga pikëpamja formale në përgjithësi ankimet janë formësuar, në mos gaboj, KQZ-ja ka edhe formularët për këtë qëllim, bëhen në një formë të caktuar, pra ka një ngërç të vogël me elementet e formës. Megjithatë, ne në këtë fazë nuk kemi as aktin e KZAZ-së, pra edhe ne vetë jemi të paplotësuar, nuk e di çfarë mund të bëjmë. Nuk e di a do ta shtyjmë?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 4

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. E. Lako:** Formalisht, praktika shumëvjeçare këtu është si në gjykatë që kur çon një padi e nuk ke të identifikuar adresën apo një element të caktuar, të jepet koha ta plotësosh atë padi si në elementin formal, pra identifikon shkeljen ligjore, pra do një punë juristi ta rregullojë këtë pjesë, të ndihmon edhe administrata e KQZ-së, dhe ndërkaq ne fitojmë edhe kohën e nevojshme që të administrojmë aktet e KZAZ-së që të çmojmë ku jemi. Pra, të mos ju dëgjojmë ju pa arritur te thelbi i gjësë.

**Z. Y. Merhaj:** Nga KZAZ-ja nr. 6 na ka ardhur edhe vendimi me *whatsapp*, është vendimi nr.12, datë 28.3.2023, që ka argumentuar arsyen pse nuk e ka regjistruar kandidatin. Ka një vendim.

**Z. E. Lako:** Atëherë meqenëse anëtarët e KZAZ-së janë në ardhje, meqenëse u gjet edhe vendimi i KZAZ-së, me asistencën e administratës së KQZ-së, do t'ju lutesha që ta rregulloni formën dhe përmbajtjen e ankimit, duke pasur parasysh edhe vendimin që është depozituar pranë KQZ-së dhe të mblidhemi për rreth 30-45 minuta që të vazhdojmë me shqyrtimin e seancës paraprake që të mos e shtyjmë për ditë tjetër e të bëjmë përsëri seancë paraprake dhe përsëri duhet të vijmë përsëri ata nga KZAZ-ja, pra, të eliminojmë shpenzimet e tepërta dhe të konkludojmë sot me seancën paraprake. Jeni dakord?

**Z. Z. Bushati:** Jemi dakord dhe ju falënderojmë për këtë tolerancë që treguat. Besoj se do të na e falni që jemi parti e vogël, organika nuk kemi...

**Z. E. Lako:** Ne për këtë punë jemi të ndihmojmë partitë që të menaxhohen sa më mirë në këtë proces.

**Z. Z. Bushati:** Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Për gjysmë ore, 45 minuta do t'ju njoftojmë e do të mblidhemi sërish.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023  
Rifillon Seanca*

Ora 14:17

**Z. E. Lako:** Riçelim edhe njëherë seancën paraprake për çështjen ankimore nr. 44, për plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes. Zoti Merkaj ju e morët një kopje të praktikës.

**Z. Y. Merkaj:** Po.

**Z. E. Lako:** Besoj është e plotë tani.

**Z. Y. Merkaj:** Po, pas kthimit për plotësim, pala ankuese ka plotësuar elementët e formës dhe të përmbajtjes. Kërkesën Ankimore e ka bërë sipas modelit të miratuar nga KQZ, i është drejtuar KAS-it dhe është plotësuar dhe vendimi i KZAZ-së.

**Z. E. Lako:** I KZAZ-së për këtë çështje. Pra kërkohet?

**Z. Y. Merkaj:** Kërkohet ardhja në seancë për shqyrtim.

**Z. E. Lako:** Falemindertit! Përfaqësuesi i KZAZ-së meqenëse është në seancë tani, dy fjalë për plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes. Nuk i kemi hyrë në themel. Thjesht a i ka kjo kërkesë elementët e nevojshëm që i drejtohet KAS-it? A është bërë brenda afatit, dhe është përcaktuar dhe vendimi i KZAZ-së. Pra keni ndonjë opinion në këtë fazë?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. Z. Bushati, kryetar i ADK-së:** Arsyeja se pse KZAZ-ja ka marrë vendim për mosregjistrimin e subjektit në fjalë, është mangësitë që ka patur në dokumentacion. Mandati i Këshilltarit...

**Z. E. Lako:** Ju lutem nuk po shqyrtojmë themelin, këto janë argumenta. Ankesa a i plotëson kriteret që ne ta shqyrtojmë? Nëse nuk keni gjë për të thënë, thoni nuk kam gjë për të thënë.

**Z. Z. Bushati, kryetar i ADK-së :** Unë nuk mendoj se i lexon, ajo është krejtësisht e pafal...

**Z. E. Lako:** Atë do e shqyrtojmë në seancë pastaj. Po flasim për bazën ligjore, i drejtohet brenda afatit tre ditor, identifikohet vendimi i KZAZ-së përpara KAS-it? Për këto po flasim. Nëse nuk keni koment, Faleminderit. Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi:

1. Kalimin për shqyrtim të çështjes ankimoe nr. 44, me ankues Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë që kundërshton vendimin nr. 12, dt. 28.03.2023 për mosregjistrimin e listës së kandidatëve për anëtar këshilli.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 (pesë) ditëve.

Meqenëse dhe KZAZ-ja juaj ndodhet larg dhe që mos t'ju detyrojmë edhe njëherë që të vini në Tiranë, ne propozojmë të vazhdojmë direkt me shqyrtimin në themel të kësaj çështjeje, natyrisht nëse dhe ju jeni dakord. Ju lutem jeni dakord që ta vazhdojmë shqyrtimin e gjykimit të kësaj çështjeje?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

*Z. Z. Bushati, kryetar i ADK-së : Plotësisht dakord!*

*Z. E. Lako: Dhe ju përfaqësuesi i KZAZ-së jeni dakord?*

*Z. S. Shkreli, kryetar i KZAZ-së nr. 6, Vau i Dejës: Po, vazhdojmë.*

**Vendimi nr. 46**

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

04.04.2023  
Ora 14.09

**RENDI I DITËS**

**Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 45, paraqitur në KOZ, datë**

**02.04.2023**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** S'ka prezent

**Z. E. Lako:** Çelim seancën e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për verifikimin dhe plotësimin e elementeve të formës e të përmbajtjes për ankimin nr. 45, me subjekt ankues Aleanca Progresiste LZHK me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 20, datë 30.3.2023 të KZAZ-së nr. 53, Bashkia Përrenjas për mosregjistrimin e listë së kandidatëve të LZHK-së për Bashkinë Përrenjas”. Relator jam zgjedhur unë sipas shortit të hedhur dje në datën 3 prill 2023. Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Komisionit të Ankimeve e Sanksioneve. Subjekti ankues është njoftuar, nuk është paraqitur, palë të interesuar nuk ka. Dy fjalë shkurtimisht për plotësimin e elementeve të formës e të përmbajtjes, zoti Merkaj.

**Z. Y. Merkaj:** Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 45 me ankues Aleancën Progresiste LZHK, e cila kundërshton vendimin e KZAZ-së nr. 53, Bashkia Përrenjas, me numër 20, datë 30.3.2023, ora

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

21.05. Nga shqyrtimi paraprak i elementeve të formës e të përmbajtjes, konstatohet që janë në përputhje me nenin 130 të Kodit Zgjedhor, pasi plotëson kompetencat e KQZ-së, në rastin konkret të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Legjitimimi i ankuesit ka interes të ligjshëm kundër këtij vendimi, si dhe respekton afatin kohor prej 3 ditësh të parashikuar në Kodin Zgjedhor. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Ka ndonjë pyetje, ndonjë koment? Pra, ju, zoti Merkaj, administrata mendon që kjo i plotëson elementet e duhet të kalojë për shqyrtim.

**Z. Y. Merkaj:** Po, kërkojmë të kalojë për shqyrtim.

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Atëherë KAS-i, i konsultuar në vend, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim dhe caktoi seancën në datën 6 prill, në orën 13.00. Të njoftohen palët. Faleminderit!

**Vendimi nr. 47**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr. 44, datë 31.03.2023, me ankues Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, me objekt “Kundërshtimi i KZAZ-së nr. 6, Vau i Dejës, për mos regjistrimin e listës shumemërore për anëtarë të Këshillit Bashkiak””.*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike** ADK (Z. Bushati)
- **Të tjerë** Kryetar i KZAZ-së (S. Shkreli)

*Z. E. Lako:* Atëherë, çelim seancën për shqyrtimin në themel të çështjes ankimore me nr. 44 me ankues Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, me objekt “Kundërshtimi i KZAZ-së nr. 6, Vau i Dejës, për mos regjistrimin e listës shumemërore për anëtarë të këshillit bashkiak””. Relator jam zgjedhur unë Elvin Lako. Është e pranishme e gjithë trupa e KAS-it. Janë të pranishëm, ju lutem shkurtimisht edhe përfaqësuesi i ankuesit dhe i KZAZ-së, me mikrofon ju lutem identifikohuni.

*Z. Z. Bushati, kryetar i ADK-së :* Zef Bushati.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. S. Shkreli, kryetar i KZAZ-së nr. 6, Vau i Dejës:** Sokol Shkreli, kryetar i KZAZ-së nr. 6.

**Z. E. Lako:** Keni ndonjë kërkesë paraprake? Keni ndonjë konflikt interesi me ndonjë anëtar të KAS-it?

**Z. S. Shkreli, kryetar i KZAZ-së nr. 6, Vau i Dejës:** Jo.

**Z. E. Lako:** Ju zoti Bushati?

**Z. Z. Bushati, kryetar i ADK-së :** Jo.

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Atëherë, zoti Sekretar i Përgjithshëm dy fjalë shkurtimisht me çështjen që po gjykojmë.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, pranë KQZ-së është paraqitur Kërkesa Ankimore nr. 44, me ankues Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë e cila ankon vendimin nr. 12, dt. 28.03.2023 të KZAZ-së nr. 6, e cila ka vendosur mosregjistrimin e kandidatit të Aleanca Demokristiane të Shqipërisë për kryetar bashkie në Bashkinë Vau i Dejës. Arsytet e mosregjistrimit sipas vendimit nr. 12 janë mungesa e evidentmit që zotëron mandate në këshill. Gjithashtu mungojnë 15 (pesëmbëdhjetë) karta ID-je në listën shumemërore dhe lista për regjistrimin e kandidatëve nuk plotëson kuotën gjinore, pasi nuk është respektuar kuota një burrë, një grua. Për këto arsye KZAZ-ja nr. 6 ka vendosur mosregjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie me 7 (shtatë) vota pro. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, e cila do të thotë dhe arsyet se pse nuk është dakord me këtë vendim, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Falemindrit zoti Merkaj! Për ankuesin ju lutem edhe njëherë shkurtimisht cilat janë arsyet që ju e bëni këtë ankim? Ngjrrjen edhe njëherë çfarë ka ndodhur dhe ku e pretendoni atë çfarë kërkoni nga ky komision.

**Z. Z. Bushati, kryetar i ADK-së :** T'ju njoh me vendimin. Kryetari i KZAZ-së ka komunikuar vetëm nëpërmjet telefonit me të autorizuarin e Partisë Aleanca Demokristiane, për të depozituar dokumentet e këshilltarëve, kandidatëve për këshilltar në KZAZ. Shtohet edhe një akuzë nga ana e kryetarit këtu që ne nuk kemi nga këshilli vërtetimin që kemi anëtarë të këshillit në Këshillin aktual të Vaut të Dejes. Këshilltari jonë ka 4 (katër) vite atje që merr pjesë, e njeh gjithë Vau i Dejes. Unë e kam pyetur këtë djalin e autorizuar për tu marrë me këto dokumentacione dhe më ka thënë që ne e kemi marrë nga këshilli dhe ja kemi dorëzuar komisionit, megjithatë kjo është një çështje thjesht shkresore sepse vet ai e di shumë mirë që kandidati jonë, një personazh jo pak i njohur sepse ka disa legjislatura që është këshilltar i Aleancës Demokristiane dhe me këtë argument mendoj se shtohet edhe më tepër fakti që këtu kemi të bëjmë me një veprim tendencioz për ta eliminuar gjithë listën e këshilltarëve të Partisë Aleanca Demokristiane në Vaun e Dejes. Duket ngaqë e ndjen veten të sikletosur nga këshilltarët tanë dhe janë përpjekur që ta eliminojnë. Fakti flet ditën edhe natën. Më datën 27.03.2023 është paraqitur kandidati jonë, i autorizuar nga ne për të dorëzuar dokumentacionin dhe ai me shumë vrap ka rendur, në datën 28.03.2023, të nesërmen në orën 20:00 për të firmosur këtë vendim, të cilin ne e quajmë të jashtëligjshëm për faktin se ligji na jep ne në dispozicion tre ditë të plota për të

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

rregulluar të gjitha vërejtjet që ka komisioni zonal. Në komision nuk i është thënë personit tonë të autorizuar që mungon edhe ky vërtetim nga sekretaria e këshillit.

***Kandidati për këshilltar:*** Më kanë thënë që e marrin vetë.

***Z. Z. Bushati, kryetar i ADK-së :*** I kanë thënë pa problem se e marrim ne atë autorizim, e thotë vetë kandidati për këshilltar. Vetëm për të rregulluar ato çfarë ne kemi ngritur aty, listën me emra aty, femër, mashkull, femër, mashkull, edhe jo tek lista e plotë por tek një pjesë e saj dikush i kishte thënë se vetëm 30 % (tridhjetë) duhet të jenë femer, mashkull, femër, mashkull, pjesa tjetër e listës nuk ka nevojë. Këto tani janë edhe mungesa eksperience edhe tek këshilltarët, sidomos kur janë të rinj. Kandidati ynë këtë herë është i ri, që kandidon për këshilltar në Vaun e Dejës dhe megjithatë nuk e ndihmon kryetari i KZAZ-së apo ndonjë anëtar tjetër i KZAZ-së, e ndihmon ligji, cili i jep kohën për ti rregulluar këto vërejtje. Mendoj që duke mos patur kohën në dispozicion nëpërmjet ligjit, kryetari bashkë me një pjesë të anëtarëve të KZAZ-së, sepse ne kemi edhe një anëtar të KZAZ-së që na ka deklaruar që unë nuk e kam idenë fare as ku kanë shkuar as se çfarë bëjnë, por ky i takon opozitës si anëtar i KZAZ-së. Nuk kanë arritur absolutisht që të veprojnë në bazë të ligjit dhe edhe kur e ka marrë në telefon mbas 36 orësh, i ka thënë që jam në Tiranë për të dorëzuar dokumntet, në një kohë që akoma nuk kishte përfunduar afati. Përsëri kandidati ynë ka insistuar, e ka marrë dhe i ka thënë herën e fundit që... përsëri brenda afatit kohor për rregullimin e dokumentacionit që shko merr letrat aty se je i skualifikuar. Pra i gjithë komunikimi ka qenë nëpërmjet telefonatave dhe asnjëherë nuk i është dhënë asnjë lloj dokumenti në dispozicion të kandidatit apo të subjektit, të cilin unë përfaqësoj. Për momentin kaq kam njëherë, faleminderit.

***Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.04.04.2023*

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Bushati! Ju lutem përfaqësuesi i KZAZ-së edhe ju shkurtimisht çfarë ka ndodhur.

**Z. S. Shkreli, kryetar i KZAZ-së nr. 6, Vau i Dejës:** Përfaqësuesi i autorizuar i Partisë Aleanca Demokristiane, si gjithë përfaqësuesit e tjerë të autorizuar të subjekteve politike, ka dorëzuar dokumentacionin ditën e hënë, Në momentin e pranimit të dokumentacionit është verejtë...

**Z. E. Lako:** Ditën e hënë që çfarë date i bie?

**Z. S. Shkreli, kryetar i KZAZ-së nr. 6, Vau i Dejës:** Në datën 27.03.2023. Është verejtur që në dokumentet e dorëzuara mungon autorizimi, vërtetimi për zotërimin e mandatit në Këshillin e Bashkisë aktual dhe mosrespektimi i kuotës gjinore. Dokumentet janë pranuar.

**Z. E. Lako:** Kartat nuk kanë patur problem, mungesa e 15 (pesëmbëdhjetë) kartave.

**Z. S. Shkreli, kryetar i KZAZ-së nr. 6, Vau i Dejës:** Unë kam sjellë të plotë dosjen që ka depozituar kandidati, personi i autorizuar në KZAZ.

**Z. E. Lako:** Pra kanë qenë dy mungesa, vërtetimi dhe renditja gjinore.

**Z. S. Shkreli, kryetar i KZAZ-së nr. 6, Vau i Dejës:** Po, shumë e drejtë. Në bisedë, sepse ky është banor zone dhe normalisht përpos angazhimit të tij politik ne njihemi edhe në jetën e përditshme, i kemi kërkuar privatisht dhe ky është dëshmitar që të riparojë ato dy problemet që kemi evidentuar në mënyrë që sikurse

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 04.04.2023*

gjithë të tjerët ti mundësohet regjistrimi. Në mungesë të këtyre plotësimeve komisioni ka marrë vendimin që ju keni të pasqyruar në dokument. Për sa i përket pjesës tjetër në lidhje me prezencën ose jo të anëtarëve të komisionit në KZAZ, Ne kemi të afishur tek dera, tek porta hyrëse në shkollën ku është instaluar KZAZ-ja, kemi të instaluar posterin në të cilin tregohen dy oraret alternative, pra dreke dhe pas dreke dhe ajo që duhet të dijë dhe zoti Zef me nje eksperiencë shumë të kahershme në politikë, afati për mosregjistrimin e subjektit të tij politik i përket orës 20:55 në darkë. Për këtë ja di oraret sepse KQZ-ja detyron KZAZ-në të rrijë hapur dhe vetëm... ky ishte një argument për të shuar ato zërat telefon etj., etj. Se sa telefonata anëtarët e KZAZ-së kanë ato ditët e pranimit të gjithë e dini prej nesh dhe prej jush, por kushdo e di. Fakti sesi dhe në Ç'mënyrë trajtohet çështja nga kryetari i Partisë Aleanca Demokristiane më ndjeni por mua më vjen keq personalisht. Arsyeya e vetme e mosregjistrimit është thjesht mungesa e dokumentacionit. Nëse këto plotësohen dhe ju e gjykoni që regjistrohet ato hamendësimet e tij në lidhje me të ashtuquajturën frikë etj., etj., po le ti kryejë të gjitha, të regjistrohet sepse nuk përbën probem, kaq.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.4.04.2023*

**Z. E. Lako:** Faleminderit, me çfarë unë po shikoj dhe çfarë ju pohoni, është që kërkesa për regjistrim është bërë në datën 27, dhe vendimi juaj është marr në datën 28. Pra ju e keni pritur një ditë, pse është marrë në datë 28 pa arritur që ta prisni të sjellë dokumentat e kërkuara domethënë, se ka një afat që i lihet, se kjo privatisht në një farë mënyre ju e keni pritur sepse është një detyrë që e kërkon ligji, apo jo?

**Përfaqësuesi i KZAZ:** Në rastin në fjalë, jo premtimi por fakti që ky do e riparonte, dhe gjithë subjektet e tjera dokumentacionin nga ana teknike dhe ligjore e kishin plotëuar, ne menduam që ta kryejmë atë proces pa pasur zvarritje, ajo nuk doli, ne realizuam kontakte, ideja se ne kishim kontakte që hajde, eja, jemi mbyllur, jemi hapur, ajo nuk qëndron fare, kjo ishte e gjitha në lidhje me vendimmarrjen tonë, ditën e marttë, që i bie në orën 9 të darkës.

**Z. E. Lako:** Po zoti Bushati keni gjë?

**Z. Z. Bushati:** Jo, prapë ka një pasaktësi, se thotë i kemi dorëzuar dokumentat me datë 27, jashtë afatit kohor. Data 27 është data e fundit, dhe me datë 27 KZAZ-të kanë ndenjur deri në orën 12 të natës, kështu e ka ligji për të dorëzuar ne dokumentat, të gjithë jo vetëm ne, me ligj. Ne e kemi dorëzuar në orën 8 e gjsmë, ja 9 sikur ta kemi dorëzuar të darkës, prapë e kemi dorëzuar brënda afatit ligjor, jo jashtë afatit, e para. Dhe e dyta.

**Z. E. Lako:** Për saktësim, zotëria i KZAZ-së u mor me daën e nesërme kur kanë marr vendimin, përtej orarit, mesa mbaj mënd unë, përtej orarit që këta kane përcaktuar si KZAZ që qëndron hapur. Se zakonisht KZAZ-të vënë një orar aty, se nuk mund të rrinë 24 orë se është punë e pjesshme, na gjeni ne KZAZ prej kësaj ore

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.4.04.2023*

deri në këtë orë, me dy orare zakonisht, paradite dhe pasdite. Po flisja për orarin e KZAZ-së të datës 28, më korigjo nëse... Dhe nuk u morr me dorëzimin e, ato i ka marrë në dorëzim KZAZ-ja dhe i ka vlerësuar. Tani po flasim për periudhën e marrjes së vendimit që nuk ju kanë regjistruar listën, për mosdorëzimin e atyre dy dokumentave, të cilat ju pretendoni që i keni dërguar por nuk keni gjetur njeri pranë KZAZ-së. Pak a shumë ky është konflikti, apo jo?

**Z. Z. Bushati:** Po, ky është.

**Përfaqësuesi i Partisë Aleanca Demokristiane:** Me datën 27, në orën 20 e 45 mund të jetë, kanë dorëzuar gjithë dokumentacionin, ka qënë vet present ky me gjithë të tjerët aty, i ka parë listat, ka thënë ke këtë difekt renditja, femër mashkull. Më ka thënë ke dy ditë afat për ti bërë, për vërtetimin e anëtarit të këshillit bashkiak që është në bashki, e lamë me marrëveshje që një punonjës që kishte aty brënda ta marri në bashki, se këto aty e merrin më kollaj seç e marr unë. E lam kështu. Kam shkuar në datë 29, në orën 11.30 e kam marr në telefon, në orën 11.30 e kam plotësuar komplet dokumentacionin me listë tjetër të re, se më ka thënë të bëj listë, nuk kisha ku ta merrja listën atë natë unë në Tiranë. Kam ardhur të nesërmen kam marr listën, të pasnesërmen kam çuar listën, më ka thënë në telefon që nuk bën, se i kam çuar për Tiranë. Të pasnesërmen më ka thënë, me datën 29, orën 11.30 minuta më ka thënë në telefon se i kam çuar për Tiranë. Kam ardhur të marr listën në Tiranë, fotokopjen e kësaj ta marr në Tiranë.

**Z. E. Lako:** Ndonjë nga kolegët,po zoti Braho!

**Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.4.04.2023*

**Z. L. Braho:** Kam unë një pyetje për ankimuesin. Sot i keni të sakta, këtë pjesën e kuotës gjinore në listën për këshillin bashkiak?

**Z. Z. Bushati:** Po, po.

**Z. L. Braho:** Pra i keni të plotësuar këto element?

**Z. Z. Bushati:** Po, po i kemi të plotësuar patjetër.

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit!

**Z. E. Lako:** Po zoti Rusmajli!

**Z. I. Rusmajli:** Për kryetarin e KZAZ-së. Kur morët në dorëzim dokumentacionin, si për të gjithë të tjerët, a keni vënë shënime në librin e protokollit të mbledhjeve?

**Përfaqësuesi i KZAZ:** Po, sekretarja e KZAZ-së ka mbajtur shënimet përkatëse te librat respektiv,

**Z. I. Rusmajli:** Domethënë është shënuar në librat e protokollit që ka dokumentacioni këto mangësi.

**Përfaqësuesi i KZAZ:** Po, që ka këto mangësi, autorizimin dhe mosrespektimin e kuotës gjinore.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.4.04.2023*

**Z. I. Ruzmajli:** Dhe është shënuar që janë kthyer, i është kërkuar subjektit të bëjë plotësimin?

**Përfaqësuesi i KZAZ:** Për plotësim.

**Z. I. Ruzmajli:** I është caktuar afat në libër?

**Përfaqësuesi i KZAZ:** Jo nuk e kam librin, librin e protokollit të mbledhjeve nuk e kam, sekretarja duhet ta ketë plotësuar, duhet ta ketë saktësuar, duhet, për të qënë i sinqertë nuk e kujtoj.

**Z. I. Ruzmajli:** Dakord, na e konfirmon dot ose na e përgënjeshtrohet dot këtë që thotë zotëria, që thotë që me gojë i keni thënë që keni 48 orë afat? Dy ditë, se ta dy ditë.

**Përfaqësuesi i KZAZ:** Unë nuk i përkas kësaj partie për të cilën lobon zoti Zef, zoti Kryetar, por unë do isha shumë i kënaqur, mbas vendimmarrjes tuaj, që të regjistrohet, sepse nuk përbën asnjë problem. Por fakti që ne kemi marr një vendim të tillë është vetëm për këtë arsye, dhe fakti që ditën e pranimit të dokumentacionit i vetmi subjekt që ka pastur këto problematika, është vetëm ky, ne gjykuam si komision që është e paarsyeshme ta zvarrisim procesin e dorëzimit, ngaqë ishin dy formalitete shumë të thjeshta. Kjo është logjika e ndjekur nga ana jonë.

**Z. L. Braho:** Çfarë qëndrimi ka KQZ-ja pasi dëgjoi këto parashtrimet e ankimuesit, prapërsimet e KZAZ-së, nga praktika që ka ndjekur KQZ-ja. Cili është mendimi juaj në lidhje me këtë rast?

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.4.04.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Duke patur parasysh vendimin që ka marr KZAZ-ja, në momentin që ka marr vendimin ne mendojmë që ka qënë vendim i drejtë, megjithatë duke qënë se pala ankuese duhet të ketë plotësuar dokumentacionin, për ne nuk ka ndonjë problem edhe sikur të regjistrohet si, referuar dhe praktikës së KAS-it.

**Z. E. Lako:** Ju lutem se vërejtjet shoqërore mund t'i bëjmë pasi të mbaroj seanca, ju përfaqësues i KZAZ-së jeni njohur me rregullimet që i kanë bërë përfaqësuesi i ankuesit atyre dy kërkesave që ju i keni kërkuar?

**Përfaqësuesi i KZAZ:** Unë shpresoj shumë që t'i kenë plotësuar, por jam njohur me disa mesazhe në rrjetet sociale nga zoti Zef, që nuk përkojnë aspak me dëshirën e mirë për t'u regjistruar.

**Z. E. Lako:** Mirë këto janë gjëra që nuk i përkasin këtij procesi, ato janë gjëra që nuk po i shqyrtojmë sot, po flas për dokumentat që ato kanë paraqitur, pra për dy kërkesat, për vërtetimin, që ai e ka vërtetimin?

**Përfaqësuesi i KZAZ:** Deri më tani jo.

**Z. E. Lako:** Ju kur i keni dorëzuar këto zoti Bushati, e keni dorëzuar vërtetimin dhe listën e rregulluar, këto dy kërkesa?

**Z. Z. Bushati:** Që të nesërmen i ka pasur gati, por aty nuk ndodhej absolutisht asnjë njeri, ka shkuar nja 10 herë ky djali atje, është marr në telefon, ato bisedat telefonike mund t'i zbadhin tabulatet, nuk është se gënjen ky, është i sinqertë në atë që thotë.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.4.04.2023*

**Z. E. Lako:** Dorëzojini ju lutem pranë administratës së KQZ-së, edhe vërtetimin e këshillit, edhe listën. Nëse i keni, dorëzojini pranë administratës.

**Z. Z. Bushati:** Po.

**Z. I. Rusmajli:** Një pyetje.

**Z. E. Lako:** Po, zoti Rusmajli!

**Z. I. Rusmajli:** Kam kërkesë, nëqoftëse është e mundur do doja që të na dërgonin një fotokopje të librit të protokollit të mbledhjeve, ose atë ku sekretarja ka bërë shënimet për marrjen në dorëzim të dokumentacionit. Mund ta organizojmë këtë gjë nëpërmjet KQZ-së?

**Z. Y. Merkaç:** Nëqoftëse mund ta informojë KAS-in, ankuesi nuk e ka akoma as vërtetimin e mandatit, as listën.

**Z. E. Lako:** Atëhere shkurtimisht, ju ankuesit kërkonin pranimin e ankimit,

**Z. Z. Bushati:** Po.

**Z. E. Lako:** Ndërsa ju KZAZ-ja çfarë kërkonin?

**Përfaqësuesi i KZAZ:** Të realizohet plotësimi atyre dy dokumentave, dhe mundësisht të regjistrohet nga ana juaj, se elektorati pret atje.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.4.04.2023*

**Z. E. Lako:** Mirë, faleminderit! Atëhere në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi pranimin e ankesës, nga Partia Aleanca Demokristiane, dhe detyrimin e KZAZ-së numër 6, të pranojë dhe të regjistrojë listën e kandidatëve për anëtarë këshilli nga ky subjekt. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brënda 5(perë) ditësh në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Administrativ. Me kaq e deklarojmë të mbyllur këtë seancë, faleminderit!

**Vendimi nr. 48**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*

